

Data 02.02.2023
Ora 14:10

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një shtesë në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**


- | | | |
|------------|-------|-----------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ: | Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta |

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, 2 shkurt 2023. Në rendin e ditës së sotme kemi dy projektakte për të shqyrtuar. Paraprakisht po verifikoj prezencën. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës, si edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin

Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ

P.  1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

e dy projektvendimeve: 1. “Për një shtesë në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, i miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor; 2. “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV””. Para se të fillojmë me shqyrtimin e dy projektvendimeve, po pyes kolegët nëse keni çështje jashtë rendit të ditës, të cilat dëshirojnë t’i diskutojnë dhe t’i përfshijnë në rendin e ditës? Nuk kemi. Fillojmë me shqyrtimin e projektakteve. Të dy projektaktet kanë ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që do të ftoja sekretarin e Përgjithshëm, zotin Merkaj, të fillonim me projektaktin e parë, duke na prezantuar ndryshimet dhe duke bërë shpjegimet përkatëse në relacion. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Referuar Kodit Zgjedhor dhe konkretisht nenit 20, pikës 1, shkronja “a” të këtij Kodi, i cili parashikon kompetencë të Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarë të tij. Referuar këtij neni, është përgatitur edhe projektvendimi “Për një shtesë në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e KZA-së”. Qëllimi i këtij projektvendimi nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator është të përcaktojë rregullat dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Projektvendimi i propozuar për miratim përmban një shtesë në tekstin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së”, ku pas pikës 2, të nenit 7 propozohet të shtohet edhe pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit, ose të Nënkomisionerit Shtetëror të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar nga partitë politike apo për shtetasit që kanë shprehur interes për t'u emëruar kryesisht si anëtar ose sekretar të KZAZ-së". Ky ndryshim vjen si nevojë për të adresuar më mirë kompetencat që Kodi Zgjedhor i njeh Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve dhe në zbatim të nenit 14, pika 1 të Kodit Zgjedhor edhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me garancitë, me garantimin e së drejtës për të mbikëqyrur procesin e rekrutimit të zyrtarëve zgjedhorë. Në këtë rast administrata e KQZ-së ka detyrimin t'iu vendosë në dispozicion Komisionerit dhe Nënkomisionerit, krahas raportit për rezultatin e verifikimit të të dhënave të kandidatëve për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, të propozuar nga partitë politike, dhe për shtetasit që kanë shprehur interes për t'u emëruar kryesisht dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Gjithashtu, referuar edhe teknikës legislative, propozojmë të bëjmë një ndryshim në titullin e projektvendimit "Për një shtesë në rregulloren për organizmin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator". Pjesa tjetër propozojmë të hiqet. Faleminderit!

Znj. I. Nano : Faleminderit, zoti Merkaj! Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektaktit, a keni ndonjë pyetje tjetër drejtuar administratës për sqarimin e mëtejshëm të projektaktit?

Personalisht mendoj se ajo çfarë ishte shprehur në relacion diktonte nevojën për të bërë këtë ndryshim. Ndërkohë, meqë jemi ende në fazën e propozimit, si mendoni kolegë, këtë që sapo zoti Merkaj tha, ta konsiderojmë pjesë të propozimit të tyre, të administratës, apo ta hedhim në votim ndryshimin e titullit? Pra, deri në pjesën "të Komisionit Rregullator" të mos ripërmendet edhe një herë. Dakord, po e konsiderojmë propozimin e administratës me këtë titull.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Atëherë, kalojmë në diskutimin në parim të projektvendimit. A kemi ndonjë çështje për të sqaruar, apo diskutuar në parim, apo të kalojmë në votimin në parim të tij?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen apo pikë për pikë.

Komisioni Rregullator vendosi:

1. Në tekstin e rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, pas pikës 2 të nenit 7 të shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit, ose Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar nga partia politike apo për shtetasit që kanë shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtar ose sekretar të KZAZ-së”.

Nëse nuk ka diskutime kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Pika 3. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Sikundër kemi vendosur një rregull apo standard më herët, dhe në drafte nuk besoj se do të jetë një shmangie e qëllimshme, nuk e mendoj dot, por shoh që nuk është vendosur se kush ngarkohet për zbatimin e këtij akti, kështu që le të jetë si rregull në vijim që ngarkimi për zbatimin e këtij akti përgjithësisht të jetë pjesë e draftit të aktit.

Znj. I. Nano: Po, dakord.

Znj. H. Vukaj: Sot, në këtë akt, kjo është detyrë e administratës kështu që le të shtohet një pikë, pra propozoj për të ngarkuar administratën për zbatimin e këtij akti.

Znj. I. Nano: Parimisht jam shumë dakord me këtë vërejtje të zonjës Vukaj. Në fakt, ky akt bashkë me rregulloren, që është miratuar më herët, është një akt integral dhe, nëse do ta shtojmë këtu: “Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi administrata”, në fakt, kemi më tepër se administratën e KQZ-së, të paktën po flas për këtë akt të vetëm. Ndërsa këtu është e qartë, të paktën, te ky akt, që ndryshimi, që ne bëjmë, lidhet ngushtësisht me administratën. Administrata i vë në dispozicion dokumentacionin e plotë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Znj. H. Vukaj: Le të jetë si të thuash draftuesi primar administrata ose drejtoria Juridike, ose ato respektive, që zbulojnë se cilët janë subjektet, e më pas, me duar-duar shqyrtimin vlerësojmë nëse ka ndonjë subjekt tjetër të mbetur, i cili mund të shtohet në mënyrë integrale dhe të bëhet pjesë e ngarkimit.

Faleminderit!

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin në tërësi, pasi e kemi votuar në parim dhe nen për nen.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



Data 02.02.2023
Ora 14:18

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një shtesë në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Kalojmë në shqyrtimin e projektaktit të dytë, projektvendim “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV””.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Edhe ky projektakt ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Më aq sa është shqyrtuar edhe nga ana jonë, një pjesë e ndryshimeve apo e shtesave të propozuara janë në harmoni edhe me aktin që sapo miratuar, megjithatë ka edhe ndryshime të tjera, kështu që do të ftoja Sekretarin e Përgjithshëm, zotin Merkaj, të prezantonte nevojën për ndryshim, ndryshimet konkrete dhe shpjegimin përkatës.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 20 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohen kompetencat e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, është përgatitur edhe projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV””.

Këto ndryshime vijnë si nevojë për të adresuar më mirë kompetencat që Kodi Zgjedhor u njeh Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe, në zbatim të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me garantimin e së drejtës për të mbikëqyrur procesin e rekrutimit të zyrtarëve zgjedhorë. Në këtë rast administrata e KQZ-së ka detyrimin t’u vendosë në dispozicion Komisionerit dhe Nënkomisionerit, krahas raportit për rezultatet e verifikimit të të dhënave të shtetasve që kanë shprehur interes për të punuar kryesisht në KZAZ dhe KQV, edhe dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat që ka shprehur interes. Njëkohësisht ky projektvendim propozon edhe heqjen nga akti në fuqi për parashikimin për zyrat rajonale zgjedhore duke qenë se kjo strukturë nuk është më në fuqi. Ky udhëzim ka dalë në bazë e për zbatim të nenit 20, pika 1, të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Projektakti i propozuar për miratim përmban këto ndryshime: në shkronjën “c”, pika 2, të nenit 5 hiqen fjalët “ose zyrat rajonale zgjedhore” dhe në shkronjën “c”, pika 2, të nenit 10 hiqen fjalët “ose zyrat rajonale zgjedhore”. Gjithashtu, pas pikës 2 të nenit 6 të shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit ose Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar të KZAZ-së.” Gjithashtu, pas pikës 2 të nenit 11 të shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit ose Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar i Komisionit të Qendrës së Votimit.” Për sa më sipër keni projektvendimin për shqyrtim e miratim. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Sikurse u relatua nga ana juaj, ndryshimet dhe shtesat konsistojnë, së pari, në heqjen e fjalëve “zyrat rajonale zgjedhore”, të cilat nuk ekzistojnë më dhe, së dyti, janë pak a shumë ato ndryshime që ne i miratuar edhe në projektaktin e kaluar, pra vënien në dispozicion të dokumentacionit të paraqitur qoftë të Komisionerit ose Nënkomisionerit me kërkesë të tyre. Kolegë, çelim diskutimin dhe më tej vijojmë me miratimin në parim. Kemi diçka në parim me projektin? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Në momentin që po relatonte Sekretari i Përgjithshëm, kolegu Çaka kërkoi të diskutonte diçka në lidhje me teknikën e të shkruarit. Po, zoti Çaka.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

Z. D. Çaka: Faleminderit, kryetare! Duke pasur parasysh ndërtimin e projektvendimit, shoh që mbas fjalës “vendosi” thotë “në udhëzimin nr. 2 të Komisionit Rregullator bëhen këto ndryshime” dhe vazhdon me një renditje, 1, 2, 3, 4, që konsistojnë në ndryshime e shtesa e pastaj “5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë” dhe pika 6, kundër këtij vendimi, e drejta e ankimit”. Unë propozoj që të themi: “Komisioni Rregullator vendosi: 1. Në udhëzimin nr. 2 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa” dhe të kenë numërtimet siç janë në draft dhe pastaj pika 5, që është “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë” të bëhet pika 2 e aktit dhe pika 6, që është “Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegj Zgjedhor” të jetë pika 3 e aktit.

Znj. I. Nano: Zonja Koja keni gjë për sa i përket teknikës së aktit që të dimë si t’i numërtojmë pikat gjatë votimit?

Atëherë kolegë, nuk është propozim për t’u votuar, është për t’u rregulluar, është e njejta logjikë që përdori zonja Vukaj në aktin e mëparshëm.

Atëherë Komisioni Rregullator vendosi:

“1.Në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator bëhen këto ndryshime dhe shtesa: në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 5 hiqen fjalët “ose zyrave rajonale zgjedhore”. Pas pikës 2 të nenit 6 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit ose Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar të KZAZ-së.”, ndoshta kjo edhe gjuhësisht duhet të rregullohet, sepse e kemi në numrin njëjës “çdo shtetas ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar”, gjithsesi gjatë redaktimit le të shihet; në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 10 hiqen fjalët “ose zyrave rajonale zgjedhore”; pas pikës 2 të nenit 11 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje: “Me kërkesë të Komisionerit ose Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së vë në dispozicion dokumentacionin e

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2023*

plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t'u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar të KQV-së.”

Kolegë, votojmë pikën 1 ose nëse ka diskutime...

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2 “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

“Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, edhe një herë vullnetin tuaj, kolegë.

Kush është dakord me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës për të diskutuar për mbledhjen e sotme, kështu që e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Faleminderit!

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

